

Politike Një vit më pas, Meta u ngjall • **Aktualitet** Epidemia e diplomave firmato
Balkan Tadiçi zbulon Putinin • **Personazh** Muntaz Dhrami, i fundmi i një plejade


Klan

LEKË 300, 3 EURO

NR 770 VITI XVI 8 QERSHOR 2012

Këngëtarja Vesa
Luma, 26 vjeçe,
pozon për Klan

foto Gent Shkullaku



PERSONAZH **I fundmi i plejadës**

Brezi i skulptorëve që ngritën monumente në mbarë Shqipërinë. Këndvështrimi i Dhramit për konkursin e 100-vjetorit të pavarësisë dhe puna që kryen në studio magazine. Skulptori i monumentit të Ali Pashë Tepelenës, të pavarësisë dhe Nënës Shqipëri... nga Sebi Alla

ME SKULPTORIN 76 VJEÇAR MUMTAS DHRAMI


I fundmi i plejadës

Brezi i skulptorëve që ngritën monumente në mbarë Shqipërinë. Këndvështrimi i Dhramit për konkursin e 100-vjetorit të pavarësisë dhe puna që kryen në studion magazinë. Skulptori i monumentit të Ali Pashë Tepelenës, të pavarësisë dhe Nënës Shqipëri...

NGA SEBIALLA

Doren ta zgjat të mblodhur dhe detyrohesh të pëshpesh me të në krye. Eshhtë i shtëri balte në troba, duart të ngryera deri në flezë dhe përballë vështrimit të tij të impetrit, të duhet pak kohë t'i mboshtë mendjen që të bëjnë një bashkëbisedim për revolutën. Përdydim, puna që ka në dorë ja bën të vështirë përfundimin. Përpuna rrah, me pashkë në njeriun dorë dhe me dylltë qafëhehedhur, ndodhet Adem Jashari. Një burrë i fisëm që ka një ngulshmëri mbresënese me luftatari rilindës, por që është henn i kohëve moderne të Kosovës. Vepërën e sheh nga pashë skulptori i popullit Muntas Dhrami. Profesori 76-vjeçar (ka dhënë panjen e duhur monumentit dhe ndonese modesti e shoqëron në çdo frazë që thotë, nuk e tshëh në vj gerimin që ndjehet. Aty është mundësi i katër muajve punë krijese, fuzikë dhe studimore. Çdo minutier shtëhet me detaje, sepe vepra mbetet për vite, dekada dhe shekuj dhe pas një emri henn, monumenti apo skulptura, tshëhet edhe autori. Në këtë rast henn të bëjnë me një skulptor që emri i tregon dhunë, aq sa edhe në profesionin e tij mund të qubet nga të paktët që kanë lënë vepra të mëdha. Në atë studio ka edhe të tjera monumente,

Shumica, figura historike ku skulptori ngjan sikur i ka mblodhur të gjithë për t'i bashkuar në një hapësirë të përfshikët, sa gati të japin idenë se ende mbajmë imbi supë hallet e kombit të trazuar; të një vendi ku në 100 vite shtet ende grunden për pushtetin dhe ku andrrallat e një shoqërie të varfër që konsumon politikë po aq shpehë sa vulltet e ditës janë po ato të një shekulli më parë...



Skulptori Muntas Dhrami në studion e tij. Lart, portret "Njga me shah". Poshtë, Dhrami me dy kolegët e tij, Kristac Rama dhe Shaban Hadri për një monument "Nënë Shqipëri" dhe skulptura "Palljja"

Me duart e mblodhura për lutje, Nënë Tereza qëndron në cepin e galerisë së Muntas Dhramit dhe të jep idenë sikur po lutet për shpirtat e atyre që e deshen shumë këtë vend. Një prej atyre busteve që është

hedhur në balte dhe ka nisur të marrë formën e duhur, është edhe ai i Shahin Toçit. Monumenti i të riut Toçi që u vra në mes të Romës sepse nuk beri betimin si ushtarak para flamurit fashist, është ndër të freskët. Mbi të dhe Adem Jashari, profesor Muntas Dhrami po hedh formën e duhur me balte argjile dhe më pas edhe në bronz. Jashari do të ngrihet pas disa kohësh në një nga shtesht e Tiranes, ndërsa i riut Toçi në vendlindjen e tij në Burrel. Por nëse skulptori ka pas shumë monumente në mbarë Shqipërinë dhe Kosovën, përveçin ku ai shkruan punën e tij nuk mund të thuhet aq fjalë të mura.

Një etë e

LEPITI

rendë të mbush hundët apo futesh në një dorë të madhe, që ngjan si magazinë, punishte, objekt i braktisur, apo çdo emër tjetër që mund t'i vendosësh. Nuk është ndonjë ndertese moderne, përkundrazi shih nga çanta e lartë futet kudo, por përsëri Dhrami ay është mesur të shprehë talentin e tij, dhe e quan studio. I ka qëlluar fati që të jetë gjallë dhe aktiv në përvjetorin e 100 të Shqipërisë së Pavarësisë së Shqipërisë. Paqka se moshë e ka shytë drejt plejërsë, mbi të rëndojnë fort edhe 57 vite veprimtari krijese të pandërprerë. Vepra të hedhura në alçqi, mermer, dru, beton dhe bronz janë në shtesht të qyteteve në Shqipëri dhe Kosovë. Në muze apo galeri kombetare, në shtetënie e qytetëreve apo në studion e tij. Vepra mbetet, ndërsa njeriu edhe mund të harrhët dhe në këtë rast një monument tregon po aq si qindra e mijëra faqe të shkruara. Kjo "raçe" njeretish që krijojnë në material të forta duhet të ishte në planin e parë këto ditë. Një perqijumore që korrespondoi me 100 vite shtet, presupohej të ishte "parada" e veprave të artit, por nuk ndodhi kështu, pasi ka diçka që nuk shkollon, sepe krijimtaria artistike nuk kryhet me fashata. Ministrisë së Kulturës më shumë se para, i nevojiteshin ide, projekte dhe kohë. Asgjërin prej tyre nuk e gjeti në monumentin e duhur. Tashmë ngjan sikur të gjithë artistët janë të gatë për të kapur kohën e huatbor,

datën 28 nëntor, kur edhe pak muaj kanë mbetur. "Për të realizuar vepra të rëndësishme nuk duhet punuar me fashatë për tre muaj. Monumentet u kushtohen ngjarjeve dhe ato jo vetëm duhet të njihen mirë, por edhe përjetohen, të ndihen dhe të preken. Nuk jam dakord që monumentin e Pavarësisë ta bëjë një gjerim. Monumenti që ngjan si një kasolle, tregon edhe se autorët nuk e njohin mirë historinë e vendit tonë". Kështu shprehhet Muntas, teksa tërheq një cigare. Ieshon një fjalë tymi dhe ngul të një pug me balte, vegja punë dhe skica monumentesh. Ndoshita si për të treguar se kur shprehjet për "fashatë", e kishite fjalën pikërisht për kohën që duhet për të ngritur një vepër arti. Për më tepër që ato do ngrihen në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe do të mbeten përgjithnjë. Dhe nuk është çudi që figurat historike si Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe Luigj Gurakuqi të marrin panjen e një çobani, fermeri, apo biznesmeni. Sepse pikërisht po lhet në duart e disa artistëve që jo vetëm nuk patën kohën e duhur për të treguar veten, por u përsgodhën nxirrmiti. Ku më shumë se do të "shëun" emrin e tyre si artistë, ata po "bëjnë" projektin, me idenë e marrjes së disa parave, pa merrtur se vepra do mbesë në mesin e kryeqytetit. Një vepër e krijuar me shpejtësi, ngjan si një punë e bërë me normë, ku vetëm për

squimë artistike nuk mund të flitet. Profesor Muntas ka metodën e tij të krijimtarië. Ai rrah është ripridhues i një fotografie që vjen si potosi për të kthyer në bust apo monument. Kërkon me shumë të dije për personazhin e tij. Të paktën një muaj kohë e zë vetëm me leximin për historinë e personazhit, veshtron me kujdes vendin ku do të vendoset monumenti dhe pasi ka krijuar në mendjen e tij karakterin e personazhit, nis t'i japë formën. Në fillim haditet skica (formë vizatimi), behen magjet dhe më pas fillon procesi i parë për ngritjen e monumentit. E nëll është edhe historia e Shahin Toçit, një ushtaraku shqiptar që kur Italia fashiste kishte pushtuar Shqipërinë, u ndodh me studime në Romë. Refuzoi në mënyrë publike betimin para flamurit italian dhe në mënyrë demonstrative nga goksu nxorri flamurin tonë dhe shqiptoi fjalët: "Bëtohem vetëm para flamurit shqiptar". Kjo i kushtoi jetën të riut, kur u vra pabeshtit pas shpinë nga policia sekrete italiane. Tashmë kohët kanë ndryshuar dhe për këtë figurë, keshilli bashkiak në Burrel ka marrë vendim që të ngrihet një bust në nder të dëshmorit. Për të kompozuar në skulpturë një personazh nevojitet që të njohesh historinë e tij, jetën, veprimtarinë dhe mënyrën e ndarjes nga jeta. Në këtë mënyrë skulptura duhet të flisë dhe mos jetë një imitimi i një fotografie. Prandaj


PERSONAZH

nevojitet shumë kohë studimore që të piquet në kokën e skulptorit personazhi dhe vepra. Për bustin e Toçit mendova që fjalët që tha para se të vritej t'i skalis edhe në bust", shprehet Dhrami.

Po aq të lehtë për të vendosur në pamje luftëtari e vizionari, pati edhe për heroin e Kosovës Adem Jashari. Monumenti i tij lartësohet gati tre metra nga toka, pa logarituar bazamentin. Skulptori që ka lënë gjurmët e tij në shumë monumente dhe lapidare në Shqipëri, është ndër më të kërkuarit në Kosovë. Përfaqësues të pushtetit lokal, shoqata të ndryshme, por edhe individë, bëjnë porosi tek 76-vjeçari që ende nuk ka shkruar në një libër kujtimet e tij. Dhe ka një arsye, sepse më shumë se supersticion (kush shkruan kujtimet, e ka mbyllur karrierën), ai nuk ka kohë të ulet dhe shkruajë. Sepse ditën e angazhon me skulpturat e tij, ndërsa mbrëmjen me leximin e veprimtarisë së personazheve. Shumë kohë iu desh për të formësuar monumentin e Ali Pashë Tepelenës. Shumëkush që e ka parë atë vepër ka ndaluar për disa çaste. Nga puna fillestare deri në fundin e saj, kjo është vepër e skulptorit Mumtas Dhrami. "Më është dashur gati një vit e gjysëm punë për të bërë atë vepër", kujton ai. Ndërsa nuk lë pa përmendur edhe përmendoren e Drashovicës. Një lapidar gjigand dhe monumente të disa luftëtarëve në qendër të tij. E megjithatë secila punë nuk mund të harrohet, por ndodh që disa të ngelin më shumë në mendje. Një prej tyre që lidhet edhe me dy emra të njohur të skulptorëve të tjerë është monumenti i "Nënë Shqipëri" dhe "Monumenti i Pavarësisë në Vlorë". "Në të dyja këto vepra kam qenë bashkëautor me Kristaq Ramën dhe Shaban Hadërin",

shprehet Dhrami. Që të dy nuk jetojnë më, por profesori i ka fare pranë... Jo vetëm se prej dekadash ka qenë koleg me ta, por ngjitur me studion e tij, janë edhe punët e Ramës dhe Hadërit. Në njërin prej karabinave janë futur disa familje të pastreha, ndërsa tjetra ka disa vepra që kanë mbetur në atë fond kulturor. Plejada e skulptorëve me emër tashmë duket se po shkon drejt shuarjes. Në këtë periudhë kur moshë bën të sajën, Dhrami tentoi edhe një herë të lërë një vepër të tijën. Duke pasur në mendje edhe veprën e parë që kishte ngritur bashkë me kolegët në "Monumentin e Pavarësisë në Vlorë". Po me aq pasion vuri në vepër edhe një monument për Ismail Qemalin. Më saktë çoi dy projekte, por asnjë prej tyre nuk u kualifikua. Mbetën vetëm disa statuja të vogla në studion e skulptorit të popullit.

Ndonëse Dhrami këmbëngul se ka dhe do të ketë skulptorë me emër në vend, përsëri vështirë të na bindë, kur për konkursin e hapur për veprat në 100-vjetorin e pavarësisë mediokriteti i artistëve kapi majat. Më shumë se për shifra mararamendëse për ngritje parlamenti, apo për prishje objektësh, kërkohej që të paktën në këto 100 vite shtet të linim disa vepra që nga brezat e ardhshëm të vlerësoheshin. Ikim nga godina e përhimtë, e zyrtë dhe e shkatërruar e Dhramit duke kuptuar se arti bëhet edhe në kushte të vështira. Nuk nevojiten tendera dhe projekte në kompjutera, por punë në terren. Dera e parë ishte studioja e Kristaq Ramës, e dyta e Shaban Hadërit, ndërsa e treta është ende e profesor Mumtas Dhramit. Njihet nga të gjithë në hyrje të Komunës së Parisit, por më shumë se shumëkush, veprat e tij flasin në bronz...



Një jetë në bronz...

Profesor Mumtasi edhe pse e ka të largët ditën e pranimit në Akademinë e Shën Pjetërburgut në Rusi, kujton muajt para se të nisej me studime, kur sapo ishte diplomuar në Liceun Artistik. Një djalos që me skulpturën e "Vajzës me shall" mori pjesë në Ekspozitën e arteve figurative në Tiranë, në vitin 1956. Bëri përshtypje ajo vepër dhe më pas punoi si skulptor në uzinën e porcelanit në Tiranë. Vetëm një vit qëndroi aty pasi me një bursë studimi jeta artistike do merrte tjetër drejtim. Për katër vite frekuentoi auditorët e Rusisë. Kthimi në Shqipëri do ta vinte përpara një tjetër jurie, ku me skulpturën e Çerçiz Topullit dhe Mihal Gramenos mbrojtë diplomën. Po në vitin 1962 punoi si profesor dhe dekan në Fakultetin e Arteve Figurative në Tiranë. Pak kohë e ushtroi veprimtarinë akademike, pasi pas tre vjetësh u dërgua në shumë vende për të ngritur monumente. Nuk u nda prej tyre për asnjë çast. Madje ka bërë aq monumente sa me shaka mund t'i thonë edhe se ke ngritur monumentin e Enverit në Gjirokastrë. Për Dhramin ishte një vepër arti dhe më shumë se personazhi vlen ajo që ndërtoi. Sepse tashmë bashkë me monumentet hijerëndë ka kthyer në skulptura edhe femra nudo, ose të tjera me nuanca erotike. Arti ka vend për të gjithë...

Monumenti i Adem Jasharit dhe autori veprës Mumtas Dhrami. Lart: monumenti i Pavarësisë në Vlorë

